

1. Informacion Bazë

- Viti i Themelimit: 2008
- Statusi Ligjor: OJQ
- Selia Qendrore: Njësia Administrative Papër , godina 40, Elbasan.
- Faqja e Internetit: <https://www.albnatyra.org>
- Email kryesor i organizatës: racfp.org@gmail.com
- Telefoni kryesor i organizatës: +355686724681

2. Misioni

Misioni ynë është të mbrojmë dhe të promovojmë trashëgiminë e pasur natyrore të Shqipërisë, duke krijuar një të ardhme ku zhvillimi i qëndrueshëm dhe mirëqenia e komuniteteve janë në harmoni me natyrën. Ne besojmë se çdo qytetar, qoftë në zonat rurale apo urbane, duhet të ndjejë përfitimet e një mjedisi të shëndetshëm dhe të lulëzuar.

3. Vizioni (Opsionale)

Një e ardhme ku natyra dhe mirëqenia e qytetarëve janë në zemër të zhvillimit të qëndrueshëm, duke garantuar që interesat e të gjitha grupeve shoqërore të përfaqësohen dhe promovohen. Përmes edukimit, ndërgjegjësimit, avokimit dhe veprimeve konkrete, ne synojmë të mbrojmë dhe pasurojmë vlerat natyrore dhe socio-ekonomike të zonave rurale dhe urbane, duke krijuar një impakt pozitiv e të qëndrueshëm në shoqërinë shqiptare.

4. Fushat Kryesore të Fokusit

Ruajtja e biodiversitetit
Edukimi mjedisor dhe angazhimi i të rinjve
Menaxhimi i qëndrueshëm i zonave të mbrojtura
Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm

5. Aktivitetet/Programet Kryesore

Mbrojtja dhe promovimi i vlerave të natyrës Shqiptare, si: biodiversitetin, ekosistemet, habitatet, florën, faunën dhe specieve të rrezikuara.

Zhvillimin Rural dhe social-ekonomik për përmirësimin e cilësisë së jetës të qytetarëve në zonat rurale dhe urbane.

Promovimin dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të Eko-Turizmit, Agro-turizmit dhe Agropylltarisë.

Ekspertizë dhe mbështetja e politikave mjedisore për çështjet e ndryshimeve klimatike, ngrohjes globale, ndotjes dhe përqaftimi i praktikave më të mira në energjinë e gjelbërt.

Edukimi dhe mbështetja e brezit të ri dhe respektimi i të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, etnike, etj.

Për projekte specifike dhe të detajuara mund të shikoni linkun e mëposhtëm.

Shoqata AlbNatyra

<https://www.albnatyra.org/projekte/>

6. Shtrirja Gjeografike

AlbNatyra operon kryesisht në qarkun e Elbasanit, me projekte aktive në Parkun Kombëtar Shebenik dhe zonat përreth si Librazhd, Qarrishtë, Rrajcë, Hotolisht dhe Polis. Gjithashtu, organizata bashkëpunon në projekte me ndikim rajonal dhe kombëtar në partneritet me institucione publike dhe organizata ndërkombëtare.

7. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv/CEO: Gezim Shuli

Bordi i Drejtuesve:

Lirie Bezhani (Kryetar)

Majlinda Alliu

Ndricim Reka

Floreta Sula

Gani Pole

Fatmir Mema

Ymer Deja

8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet (Opsionale)

AlbNatyra ka zhvilluar partneritete të shumta me institucione vendore dhe ndërkombëtare në fushën e ruajtjes së natyrës dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Disa nga bashkëpunimet kryesore përfshijnë:

- **Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Elbasan (AdZM)**
- **PONT – Prespa Ohrid Nature Trust**
- **CEPF – Critical Ecosystem Partnership Fund**
- **PPNEA – Protection and Preservation of Natural Environment in Albania**
- **UNDP – United Nation Development Program**
- **Organizata lokale të komunitetit** në zonën e Parkut Kombëtar Shebenik
- Bashkëpunime me **ekspertë të pavarur** në fushat e biodiversitetit, edukimit mjedisor dhe menaxhimit të zjarreve.

9. Ndikimi (Opsionale)

300+ të rinj të përfshirë në kampe edukative dhe shkolla verore për biodiversitetin në Parkun Kombëtar Shebenik

11 vullnetarë të trajnuar si grup i parë reagimi ndaj zjarreve në zonat e mbrojtura

1000+ pjesëmarrës në fushata sensibilizuese dhe aktivitete ndërgjegjësuere në komunitet

500 pemë të mbjella në kuadër të nismave për restaurimin e natyrës

15 kamera kurth të vendosura për monitorimin e faunës, duke dokumentuar edhe prezencën e rrallë të rrisë ballkanike

Kontribut në hartimin e planeve lokale për menaxhimin e zjarreve dhe promovimin e turizmit të qëndrueshëm

Prodhim i një udhëzuesi botanik për turistët dhe edukimin mjedisor